



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Letërsi e re Greke B2

Ngarkesa në orë/kredite: 40 orë mësimore, 4 kredite, (20 leksione, 20 seminare)
Viti / Semestri: Viti II, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe Interpretim në gjuhën greke dhe angleze”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon që studentët të përvetësojnë njohuri të thelluara mbi letërsinë e re greke dhe zhvillimin e saj historik e kulturor. Ata do të aftësohen të analizojnë kritikisht veprat letrare dhe të kuptojnë ndikimet që kanë pasur në identitetin kombëtar grek. Në fund të kursit, studentët do të jenë të aftë të interpretojnë dhe krahasojnë tema letrare në kontekstin e zhvillimeve të ndryshme kulturore dhe të kuptojnë rolin e rëndësishëm të letërsisë në formimin e kulturës moderne greke.

Objektivat specifike lëndore:

1. Analizojnë dhe interpretojnë veprat letrare të periudhës moderne greke në kontekstin historik dhe kulturor.
2. Identifikojnë ndikimin e këtyre veprave në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar grek.
3. Krahasojnë dhe vlerësojnë kontributin e autorëve të ndryshëm në zhvillimin e letërsisë greke.
4. Aplikojnë njohuritë teorike për të kryer studime kritike mbi tema të caktuara letrare dhe historike të kësaj periudhe.

Rezultate të pritshme:

1. Analizojnë dhe interpretojnë në mënyrë kritike veprat letrare të periudhës moderne greke.
2. Identifikojnë dhe vlerësojnë ndikimin historik dhe kulturor të këtyre veprave.
3. Diskutojnë kontributin e autorëve të ndryshëm në ruajtjen e identitetit kombëtar grek.
4. Kryejnë studime dhe kërkime të thelluara mbi tema letrare të periudhës së re greke.